

## POLICY BRIEF

# Shqipëria e Pabarabartë: Përqendrimi i Pasurisë, Kapja e Burimeve Kombëtare dhe Kostoja e Rishpërndarjes së Dobët

Maj 2026 | Tiranë, Shqipëri

Burim: Polifakt.al / ALTAX — Qendra e Kërkimeve Fiskale dhe Ekonomike

58%

e depozitave tek 7% e llogarive

€1.15 mld

humbje vjetore nga korrupsioni & keqmenaxhimi

€490

humbje potenciale per frymë / vit

## Rezumeja Ekzekutive

Pabarazia ekonomike në Shqipëri tejkalon ndjeshëm atë që reflektojnë treguesit zyrtarë. Treguesi Gini i të ardhurave (~29.4) krijon përshtypjen e një ekonomie relativisht të ekuilibruar, por fsheh realitetin e përqendrimit të lartë të pasurisë, kapitalit likuid dhe aksesit ndaj burimeve publike.

Mbi 58% e depozitave individuale bankare kontrollohen nga vetëm 7% e llogarive. Shpenzimet sociale mbeten ndër më të ulëtat në Europë (~9–13% të PBB-së kundrejt 25–30% të mesatares së BE-së). Humbjet nga korrupsioni, kontratat joeficiente dhe kapja e burimeve kombëtare vlerësohen në rreth 1.15 miliardë euro në vit, ose rreth 490 euro për çdo banor.

*Nëse humbjet nga korrupsioni dhe keqmenaxhimi i burimeve do të kanalizoheshin drejt investimeve sociale dhe zhvillimit produktiv, çdo familje shqiptare me 4 anëtarë do të përfitonte potencialisht ekuivalentin e ~1,960 eurove në vit në formën e shërbimeve, mbështetjes sociale ose uljes së barrës fiskale.*

## 1. Pamja e Dyanshme e Pabarazisë

Treguesi Gini i Shqipërisë luhet në intervalin 29–34 pikë gjatë dy dekadave të fundit, duke arritur rreth 29.4 në periudhën e fundit. Në terma statistikore, kjo krijon perceptimin e një ekonomie që ka shmangur polarizimin ekstrem të të ardhurave. Megjithatë, kjo panoramë është vetëm sipërfaqësore.

Nën të fshihet një strukturë shumë më e thellë e përqendrimit të pasurisë, kapitalit likuid dhe aksesit ndaj burimeve publike, e cila nuk kapet plotësisht nga matjet tradicionale të të ardhurave.

Banka e Shqipërisë konfirmon një Gini të pasurisë neto në intervalin 38–46%, ndërsa 10% më të pasurit zotërojnë një pjesë disproporcionale të pasurisë totale.

Mbi 82% e qytetarëve e perceptojnë pabarazinë si të lartë dhe në rritje, çka tregon se eksperiencia reale ekonomike është shumë më e rëndë sesa ajo që reflektohet në statistikat klasike.

Treguesi	Vlera / Intervali	Burimi
Gini i të ardhurave	29–34 (aktualisht ~29.4)	Banka Botërore
Gini i pasurisë neto	38–46%	Banka e Shqipërisë, HWS
Perceptimi publik i pabarazisë	>82% e perceptojnë si të lartë	Sondazhe rajonale
10% më të pasurit, pjesa e pasurisë	Disproporcionale	Banka e Shqipërisë


## 2. Përqendrimi i Depozitave, dëshmi direkte e Pabarazisë

Sipas analizave të ALTAX për periudhën 2024–2025, mbi 58% e depozitave individuale në sistemin bankar kontrollohen nga vetëm 5–7% e llogarive bankare. Nga rreth 1.84 milionë depozita aktive:

- ▶ 93% e depozituesve zotërojnë mesatarisht rreth 3,100 euro secili (~42% e totalit)
- ▶ 7% e llogarive "të pasura" mbajnë mesatarisht rreth 59,000 euro (~58% e totalit)
- ▶ Totali i depozitave individuale arrin rreth 13 miliardë euro

Ndryshe nga të ardhurat, të cilat mund të maskohen nga informaliteti depozitat japin një pamje më të drejtpërdrejtë të kapitalit të akumuluar. Kapitali likuid nuk shpërndahet sipas logjikës së një tregu konkurrues, por sipas mekanizmit ku "pasuria prodhon më shumë pasuri".

### Përqendrimi i depozitave individuale — Shqipëri 2024-2025



Grafiku 1: Struktura e depozitave individuale bankare — Shqipëri 2024–2025 | Burimi: Agjencia e Sigurimit të Depozitave, analiza ALTAX

Segmenti	Numri relativ	Mesatarja / depozitë	Pesha në total
93% e depozitave zakonshme	Shumica e popullsisë	~3,100 €	~42%
7% e depozitave të pasura	Pakicë me kapital të lartë	~59,000 €	~58%

### 3. Struktura fiskale dhe mekanizmat e kapjes

Problemi i pabarazisë nuk lidhet vetëm me ekzistencën e pasurisë së përqendruar, por me mënyrën se si ajo është krijuar dhe si riprodhohet. Në Shqipëri, ky ekuilibër mbetet i dobët:

- ▶ Sistemi fiskal mbështetet kryesisht te TVSH-ja dhe taksat indirekte, të cilat proporcionalisht rëndojnë më shumë shtresat me të ardhura të ulëta
- ▶ Kontratat publike, koncesionet dhe privatizimeve kanë shpërndarë rentën ekonomike te grupet me akses preferencial
- ▶ Pasuria kombëtare (toka publike, asetet shtetërore, renta ekonomike) nuk është alokuar përmes tregut konkurrues
- ▶ Informaliteti i lartë nënvlërëson pabarazinë reale dhe tkurr bazën tatimore

Kjo ka prodhuar një ekonomi ku një pjesë e konsiderueshme e rritjes nuk buron nga produktiviteti, por nga afërsia me vendimmarrjen publike, fenomen i njohur si "rent-seeking" ose klientelizëm ekonomik.

Element strukturor	Efekti ekonomik
Dominimi i TVSH-së dhe taksave indirekte	Ngarkesë më e lartë mbi shtresat e varfra
Koncesione dhe prokurime të përqendruara	Transferim i rentës publike te pakica
Informaliteti i lartë	Nënvlerësim i pabarazisë reale
Mungesë transparence mbi pasuritë	Vështirësi në matjen reale të kapitalit
Kapje politike e resurseve	Dobësim i konkurrencës dhe meritokracisë


### 4. Dobiësitë e Shpenzimeve Sociale

Shqipëria renditet ndër vendet me shpenzimet më të ulëta sociale në Europë dhe rajon. Shpenzimet për mbrojtje sociale luhaten nga 9 në 13% të PBB-së, ndërkohë që:

- ▶ Mesatarja e BE-së arrin 25–30% të PBB-së
- ▶ Vendet nordike shkojnë mbi 30% të PBB-së
- ▶ Rreziku i varfërisë dhe përjashtimit social mbetet rreth 46%, sidomos në zonat rurale
- ▶ Pensionet konsumojnë pjesën dominuese të buxhetit social, duke lënë investime minimale në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale

Shpenzimet e pamjaftueshme sociale nënkuptojnë se rritja ekonomike nuk transformohet në mirëqenie të shpërndarë, por në zgjerim të diferencave ekzistuese.

## Krahasimi i shpenzimeve për mbrojtje sociale (% e PBB-së)



Grafiku 2: Krahasimi i shpenzimeve për mbrojtje sociale (% e PBB-së) | Burimi: Eurostat, Banka Botërore, INSTAT — analiza ALTAX

Vendi / Grupi	% e PBB-së	Diferenca me Shqipërinë
Shqipëria (aktuale)	~9–13%	—
Mesatarja e BE-së	~25–30%	+16–17 pp
Vendet Nordike	>30%	+18–22 pp

## 5. Kostoja Ekonomike e Korrupsionit dhe Keqmenaxhimit

Institucionet ndërkombëtare vlerësojnë se humbjet direkte dhe indirekte nga korrupsioni, kontratat joeficiente, ekonomia klienteliste dhe abuzimi me burimet natyrore mund të arrijnë nga 3% deri 5% të PBB-së në vit.

Duke marrë një skenar konservator prej 4% të PBB-së në vitin 2025 (PBB ~27.7 miliardë euro):


Llogaritja	Vlera
PBB e Shqipërisë (2025)	~27.7 miliardë euro
Norma e humbjes (skenar konservator)	~4% e PBB-së
Humbja ekonomike vjetore e llogaritur	~1.15 miliardë euro / vit
Humbja për frymë (2.36 milionë banorë)	~490 euro / banor / vit
Humbja për familje me 4 anëtarë	~1,960 euro / familje / vit

Rreth 1.15 miliardë euro në vit mund të konsiderohen si burime të humbura ose të shpërndara joefikasht, si rezultat i korrupsionit, kapjes së shtetit, koncesioneve joeficiente dhe mosmenaxhimit të burimeve kombëtare.

## 6. Skenari Alternativ i Rishpërndarjes

Nëse humbjet nga korrupsioni dhe keqmenaxhimi do të kanalizoheshin drejt investimeve produktive dhe sociale, efekti ekonomik dhe social do të ishte transformues:

### Skenari alternativ i rishpërndarjes – 1.15 mld € në vit



Grafiku 3: Skenari alternativ i rishpërndarjes — 1.15 miliardë euro në vit | Burimi: Analiza ALTAX/Polifakt

Destinacioni i mundshëm	Vlera e mundshme
Rritje e mbrojtjes sociale +4–5% PBB (~35% e fondeve)	Afërsim me mesataren rajonale
Dyfishim i ndihmës ekonomike (~20% e fondeve)	Ulje e varfërisë ekstreme
Investime në arsim dhe shëndetësi (~22% e fondeve)	Rritje e kapitalit njerëzor
Mbështetje zonat rurale & bujqësia (~13% e fondeve)	Frenim i emigracionit
Ulje e barrës fiskale për shtresën e mesme (~10%)	Rritje e konsumit dhe formalizimit

## 7. Komentet rreth Politikave të zbatueshme

### 7.1 Reformë fiskale gjithëpërfshirëse

- ▶ Rishikimi i strukturës tatimore duke ulur peshën e TVSH-së dhe rritur progresivitetin e tatimit mbi të ardhurat dhe pasuritë
- ▶ Zbatim efektiv i tatimit mbi pasuritë e larta dhe kapitalin financiar
- ▶ Forcimi i kapaciteteve të administratës tatimore për reduktimin e evazionit fiskal

### 7.2 Transparencë dhe llogaridhënie në prokurimin publik

- ▶ Dixhitalizim i plotë dhe auditim i pavarur i kontratave publike dhe koncesioneve
- ▶ Zbatim i standardeve EITI për burimet natyrore
- ▶ Forcimi i rolit të KLSH-së dhe institucioneve të pavarura të mbikëqyrjes

### 7.3 Rritja e shpenzimeve sociale

- ▶ Caktimi i një target-i minimal prej 18–20% të PBB-së për shpenzimet sociale brenda 5 viteve
- ▶ Rritje substanciale e ndihmës ekonomike, pensioneve dhe investimeve në arsim e shëndetësi
- ▶ Politika aktive të punësimit për zonat rurale dhe grupet vulnerabël

### 7.4 Lufta kundër informalitetit dhe ekonomisë klienteliste

- ▶ Deklarim i plotë i pasurive të zyrtarëve dhe personave politikisht të ekspozuar
- ▶ Zbatim i mekanizmeve anti-monopol dhe pro-konkurrencë në tregjet kryesore
- ▶ Reduktim i barrierave administrative për bizneset e vogla dhe të mesme

## 8. Përfundimi

Shqiptarët nuk përballen vetëm me një problem pabarazie statistikore, por me një model ekonomik ku përqendrimi i pasurisë, kapja e burimeve publike dhe niveli i ulët i rishpërndarjes kanë krijuar një ekonomi me dy shpejtësi.

Depozitat bankare tregojnë qartë se pabarazia reale është shumë më e lartë sesa ajo që reflektohet nga treguesit klasikë.

Ndërkohë, politikat sociale, ndër më të dobëtat në Europë nuk arrijnë të korrigjojnë këtë përqendrim.

Nëse korrupsioni, shpërdorimi i burimeve natyrore dhe mekanizmat klientelistë do të reduktoheshin ndjeshëm, Shqipëria do të kishte potencialin të krijonte një rishpërndarje ekonomike me efekt real mbi mirëqenien, konsumin, kapitalin njerëzor dhe stabilitetin social.

*Çdo vit mosveprimi fiskal e buxhetor, si dhe ekonomia klienteliste i kushton Shqipërisë rreth 1.15 miliardë euro, ose afërsisht 490 euro për çdo banor. Reforma strukturore nuk është më domosdoshmëri sociale, por investim ekonomik me kthim të lartë.*

## Burimet dhe Metodologjia

Ky policy brief bazohet në të dhënat e mëposhtme dhe analizat e ALTAX:

- ▶ Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), të dhëna mbi strukturën e depozitave 2024–2025
- ▶ Banka e Shqipërisë, Household Wealth Survey; statistika monetare
- ▶ Banka Botërore, treguesi Gini dhe të dhëna mbi pabarazinë
- ▶ Eurostat, shpenzime sociale të vendeve të BE-së
- ▶ INSTAT, të dhëna makroekonomike dhe demografike
- ▶ Institucione ndërkombëtare rajonale (EBRD, UNODC), vlerësime mbi kostot e korrupsionit
- ▶ Polifakt.al, analiza origjinale e publikuar më 04 Maj 2026

Të gjitha llogaritjet janë të ALTAX dhe reflektojnë skenarë të bazuar mbi të dhëna publike të disponueshme. Skenari i 4% të PBB-së si normë humbjeje nga korrupsioni është konservator, duke u bazuar në intervalin 3–5% të vlerësuar nga institucione ndërkombëtare.

*Riprodhimi i përmbajtjes lejohet me citim të burimit: Polifakt / ALTAX, Maj 2026.*